



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 73 Prot.,

Tiranë, 25 .03 2024

VENDIM

Nr. 62, datë 25.03.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 25.03.2024:

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit të Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor për projektin “Ndërtim i infrastrukturës së rrjetit kabllor fibër optike, FTTH”, Brenda Kufirit Zonë Arkeologjike “A” dhe “B” Sarandë, me aplikues shoqëria ‘Korado’ dhe zhvillues subjekti **Vodafone Albania sh.a.**, me rekomandimin;
2. Gjatë procesit të zbatimit të punimeve të shfrytëzohet infrastruktura ekzistuese në mënyrë që të shmangen sa më shumë ndërhyrjet në Zonën Arkeologjike “A”.
3. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve për projektin “Ndërtim i infrastrukturës së rrjetit kabllor fibër optike, FTTH”, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt, e më pas subjekti aplikues mund të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
4. Gjatë procesit të zbatimit punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, datë 17.05.2018, neni 72, pika 1 dhe 2;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
6. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
7. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI

